

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 1, datë 17.3.2023

PËR DIAGNOSTIKIMIN DHE MJEKIMIN PRANË QENDRËS SPITALORE UNIVERSITARE DHE INSTITUCIONEVE SPITALORE RAJONALE, SI DHE PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË DETAJUARA PËR MËNYRËN E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR DHE FUNKSIONIMIN E SKEMËS SË SIGURIMEVE SHËNDETËSORE PËR PERSONAT E BURGOSUR

Në mbështetje nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të nenit 41, pikat 13 dhe 17, të ligjit nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

UDHËZOJNË:

1. Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave mbi diagnostikimin dhe mjekimin pranë Qendrës Spitalore Universitare dhe institucioneve spitalore rajonale të të burgosurit që dyshohet ose ka sëmundje ngjitëse apo sëmundje të tjera, si dhe përcaktimi i rregullave për mënyrën e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe funksionimin e skemës së sigurimeve shëndetësore për personat e burgosur.

2. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:

a) siguron trajtimin e nevojshëm dhe të specializuar shëndetësor për të burgosurit;
b) mundëson kryerjen e ekzaminimeve mjekësore të specializuara terciare apo sekondare, sipas protokolleve të miratuara në Qendrën Spitalore Universitare dhe institucionet spitalore rajonale, brenda kapaciteteve;

c) realizon konsulta të zgjeruara në shërbimet përkatëse të Qendrës Spitalore Universitare për të burgosurit me sëmundje komplekse dhe në gjendje shëndetësore të rënduar, kur është ezauruar ofrimi i shërbimit në institucionet spitalore rajonale;

ç) siguron ambiente të veçanta për trajtimin e personave të burgosur, në Qendrën Spitalore Universitare dhe institucionet spitalore rajonale;

d) siguron kryerjen e ndërhyrjeve kirurgjikale për të burgosurit, qofshin ato urgjenca kirurgjikale apo të planifikuara, në Qendrën Spitalore Universitare dhe institucionet spitalore rajonale.

3. Rastet urgjente shëndetësore të të burgosurve dhe konsultat jashtë orarit zyrtar të punës realizohen nga pavionet e urgjencës dhe mjekët e shërbimit 24-orësh (njëzetekatërorësh) në qendrën spitalore të burgjeve ose në institucionet e kujdesit shëndetësor rajonal.

4. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Institutit të Shëndetit Publik, ju ofron të burgosurve ekzaminime laboratorike, depistime epidemiologjike dhe asistencë për diagnozë, sipas nevojave të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

5. Të burgosurit përfshihen në kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë. Në zbatim të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994, “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pagesa e kontributeve të të burgosurve financohet nga buxheti i shtetit. Të burgosurit përfitojnë të gjitha shërbimet që ofron skema e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor sipas këtij ligji.

6. Në zbatim të vendimit nr. 955, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kategorive të individëve të siguruar që përjashtohen nga pagesat e drejtpërdrejta të shërbimeve shëndetësore”, të ndryshuar, të burgosurit përjashtohen nga pagesat e drejtpërdrejta për alternativat e para të barnave të listës së barnave të rimbursueshme.

7. Drejtoritë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor lidhin kontrata trepalëshe me institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe shpërndarësin farmaceutik. Në këto kontrata përcaktohen detyrimet e secilës palë. Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale pajis Drejtorinë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor me listën e mjekëve që kanë të drejtën e plotësimit të recetave me rimbursim.

8. Mjeku i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, për trajtimin me barna të rimbursueshme të të burgosurit me probleme shëndetësore, mbështetet në listën e barnave të rimbursuara dhe aktet e tjera të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, duke plotësuar recetën me rimbursim të plotë. Receta me rimbursim të plotë ekzekutohet në farmacinë e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale. Për barnat që tregtohen në farmacitë e spitaleve, pjesë e listës së barnave të rimbursuara, ndiqet procedura sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

9. Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve:

a) siguron transportin e të burgosurit, së bashku me informacionin mjekësor, nëpërmjet Policisë së Burgjeve;

b) siguron dhe ruan të burgosurit gjatë trajtimit në Qendrën Spitalore Universitare dhe institucionet spitalore rajonale në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

c) merr masat për sigurinë dhe mbrojtjen e stafit shëndetësor, pacientëve, familjarëve, vizitorëve dhe qytetarëve në ambientet e Qendrës Spitalore Universitare dhe institucioneve spitalore rajonale.

10. Memorandumi i Bashkëpunimit i ministrit të Drejtësisë dhe i ministrit të Shëndetësisë i vitit 2014, “Për sigurimin e kujdesit shëndetësor, diagnostikimin dhe mjekimin e të burgosurve nga institucionet shëndetësore në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë”, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi.

11. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Instituti i Shëndetit Publik për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu